

Plani i punës i drejtorisë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim 2018

Drejtorati për Ekonomi,Financa dhe Zhvillim i komunës së Dragashit, duke pas për bazë detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë që dalin nga dispozitat ligjore dhe statuti i komunës së Dragashit, punën dhe veprimtarinë e vetë në vitin 2018 do ta përqendrojë në:

- 1.Menaxhimin e buxhetit ne baze të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive, Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Udhëzimeve Administrative dhe Rregulave financiare të lëshuara nga MF dhe Komuna.
2. Monitorimin e regjistrimeve efikase dhe të sakta të të gjitha të hyrave, si dhe lehtësimin e rrjedhës së lirë të shpenzimeve në një mënyrë që është konsistente me rregullat e duhura të menaxhimit financiar dhe të bëjë regjistrimin e saktë të tyre.
- 3.Të përgatiten raporte financiare sipas kërkesave të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik i bazuar në paratë e gatshme dhe me statistikat qeveritare.
- 4.Të plotësohen nevojat për informata nga ana e palëve kryesore të interesuara, duke përfshirë Kuvendin, Qeverinë, Donatorët, komunitetin dhe publikun
5. Të siguroj që të bëhet barazimi sipas kërkesave te LMFPP në mes të SIMFK-së dhe Organizatës buxhetore.

6. Rritja e efikasitetit në punë në arkëtimin e të hyrave vetanake, tatimit në pronë, taksave dhe ngarkesave të ndryshme komunale dhe mundësia e gjetjës së burimeve tjera financiare, përmes donacioneve apo formave tjera,

7. Rritja e transparencës në nivelin me të lartë, para qytetarëve në grumbullimin, shfrytëzimin dhe shpenzimin e parasë publike.

PLANI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2018

Nr	Përshkrimi i detyrave të planifikuara	Afati
1	Punët përgaditore për fillimin e viti buxhetor sipas Udhëzimit Administrativ - punimi dhe dorzimi i planit të rrjedhjes së parasë së gatshme në Ministrinë e Financave-Departamenti i Thesarit	12 janar 2018
2	Barazimi i të hyrave dhe shpenzimeve me të dhënat në SIMF Sipas afateve të caktuara nga ana e MEF it Departamentit të Thesarit.	26 janar 2018
3	Përgaditja dhe dorzimi i Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më janar-dhjetor 2017 të punuara sipas Rregullës Financiare të MF 03/2013	29.01.2018
4	Regjistrimi dhe raportimi mbi të hyrat vetanake të komunës	Detyrë e përhershme

5	Regjistrimi dhe ekzekutimi i urdhërpagesave në SIMFK	Detyrë e përhershme
6	Regjistrimi dhe terheqja e avanseve për pagesa me të gatshme	Detyrë e përhershme
	Regjistrimi i bizneseve, konsulta të ndryshme rreth bizneseve, hartimi dhe vazhdimi i kontratave rreth shfrytëzimit të tokës shtetore për lokalet e përkoshme,	
7	Përgaditja e nismës për inicimin e shpenzimeve për investime kapitale Shtypja e faturave të tatimit në pronë	Shkurt 2018
8	Shperndarja e faturave të tatimit në pronë Leshuarja e aktvendimeve mbi ngarkesën e qirave vjetore për shfrytëzimin e tokës ndertimore Barazimi i te hyrave vetanake dhe shpenzimeve me te dhënat nga SIMFK	Shkurt-Mars Mars Fundi i Marsit
9	Pranimi i ankesave nga qytetaret	Mars-Prill 2018
10	Raporti periodik mbi shpenzimin e mjeteve buxhetore për periudhën janar –mars 2018	Fundi i prillit 2018
11	Raporti mbi numrin e bizneseve të regjistruara pranë qendres për regjistrimin e bizneseve në Dragash,	15 prill 2018
12	Pranimi dhe shqyrtimi i ankesave nga qytetaret	Prill-Maj 2018

13	Bartja e shitblerjeve të kontratave dhe bashkpunimi me MEF, Departamenti i tatimit ne pronë	Detyrë e përhershme
14	Raporti mbi inkasimin e mjeteve nga shfrytëzimi i tokës dhe objekteve ne pronesi te komunes me karakter te perkoheshem	Maj 2018
15	Pagesa e tatimit, leshuarja e certifikatave të ndryshme për pagesën e tatimit dhe regjistrimi i objekteve të reja	Detyrë e përhershme

16	Përgaditja dhe procesimi i urdhër zotimeve për pagesë	Detyrë e përhershme
17	Përgaditja e raportit të shpenzimeve dhe të hyrave për periudhën janar-qerrshor 2018	Korrik 2018
18	Debat publik rreth projekt propozimit të Buxhetit për vitin 2019-2021	20 korriku 2018
19	Përgaditja dhe shqyrtimi i Rregullores për vendosjen e tatimit në Pronë për vitin 2018	Fundi i korrikut
20	Debati i dytë lidhur me buxhetin 2018-2020 (varsisht nga Qarkoret Buxhetore të cilat i lëshon Ministria e Financave)	Gusht 2018
21	Shqyrtimi i Projekt Buxhetit për vitin 2019 -2021	Shtatori 2018
22	Shqyrtimi i Raportit mbi realizimin e buxhetit për periudhën janar-shtator 2018	Tetor 2018
23	Punët përgaditore rreth përmbyllje së UZP sipas afateve të cilat i përcakton MEF-i -Departamenti i Thesarit	Nentor 2018
24	Punët e përmbylljes së vitit buxhetor 2017	Dhjetori 2017

Drejtoria për Ekonomi ,Financa dhe Zhvillim do të bashkëpunojë ngusht me Organet Qeveritare të Republikës së Kosovës. Varsisht nga plani dhe programi i Ministrive përkatëse,punëtorët e këtij drejtoria do të jenë pjesëmarres të aktiviteteve në trajnime dhe ligjrate të cilat do të organizohen nga ministritë dhe asociacionet.